

Në 30-vjetorin e laureimit të Nënë Terezës me Çmimin Nobel

Gonxhe Bojaxhiu - krenari e kombit shqiptar

Gjergj Fishta ishte shkrimtari i parë shqiptar që u nominua (nga Gjermania) për çmimin Nobel. Nëna Terezë është nobelistja e parë shqiptare (1979), kurse i dyti është shqiptaro-amerikani Ferid Muradi. Edhe Ismail Kadare është nominuar disa herë për këtë çmim prestigjioz

Frrok KRISTAJ

Si zakonisht për çdo dhjetor bëhet dorëzimi i çmimit Nobel për shumë lëminjë. Çmimi Nobel për Paqe dorëzohet në Oslo të Norvegjisë, kurse për lëminjët tjera dorëzimi bëhet në Stokholm të Suedisë. Ky çmim, që është më i larti në botë, u themelua në shenjë të kujtimit të Alfred Nobel-it, që kishte zbuluar dinamitin.

Çmimi Nobel për shqiptarët është i njohur shumë herët. Shqiptari i parë që u nominua për Çmimin Nobel është Atë Gjergj Fishta, të cilin e kishin nominuar gjermanët qysh kah fundi i viteve të 30-ta të shekullit të kaluar. Fishta, ose siç njihet edhe Homeri i letërsisë shqiptare, ishte nominuar për kryeveprën “Lahuta e Malcis”. Ai kishte qenë shumë afër laurimit, sikur të mos kishin qenë rusët dhe sllavët e Ballkanit, të cilët e kishin kundërshtuar dhe akuzuar për fjalën ”shkja” për serbët, e që ishte interpretuar si fjalë ofenduese.

Dyzet vjet më vonë Nëna Tereze - nobeliste

Gonxhe (Anjesa) Bojaxhiu ishte bija e nënës Drane (Rozë) dhe babës Kolë (Nikollë) Bojaxhiu. Familja e saj kishte zbritur nga Prizreni në Shkup të Dardanisë, ku edhe u lind Gonxhja, që bota e njeh si Nëna Tereze. Ajo ishte një motër nderi e rregullit të “Misionareve të dashurisë”, që tërë jetën e vetë ia kushtoi bamirësisë, humanizmit e në veçanti dashurisë ndaj Zotit dhe dashurisë ndaj njeriut, pra dashurisë njerëzore. Vlera e saj ia kishte ulur kokën vdekjes, duke e bërë atë të pavdekshme.

Bija dhe motra jonë shqiptare, Nëna Tereze - Nëna e botës, ishte grua që dhuroi zemrën e saj, por edhe tërë jetën ia kushtoi të varfërve më të varfër - varfënjakëve, të sëmurve, bonjakëve, paqes dhe dashurisë njerëzore. Ajo në asnjë moment nuk e pranoi famën. Çdo gjë që bëri, e bëri për hir të dashurisë ndaj Zotit dhe njeriut. Ajo ishte krijesa më tokësore dhe njëherësh më hyjnore e shekullit që e kemi lënë pas.

Një bijë shqiptare bota e quajti nënë

Gonxhe Bojaxhiu, bija dhe motra jonë shqiptare, motra Tereze e Loretos dhe Nëna Tereze, pati zemër të madhe dhe të pastër, për këtë u fut në ndërgjegjen e botës pa shpikur asgjë dhe pa e udhëhequr asnjë vend. Ajo ishte investitorja më e madhe e mëshirës dhe e dashurisë. Duke marrë forcë të dobësia me mjetin më të brishtë, të dukshëm dhe të padukshëm, me eterikun, me dashurinë, Nëna Tereze u fut në dashurinë e njëzimit të mbarë botës. Për këtë edhe bota e quajti nënë një bijë shqiptare.

Nëna Tereze kishte zgjedhur gërmadhat e mishit të gjallë, por me një mision krejt të kundërt, të shenjtë dhe ringjallës. Ajo ringjallte kufomat që frymonin, në mënyrë që të paktën të vdesin si njerëz, nëse nuk jetuan si të tillë.

Nëna Tereze, para së cilës edhe bota u përkul, ishte ikonë e kohëve moderne. Ishte simbol i besimit dhe përtërirjes shpirtërore të njeriut. Bile, me legjendarizimin e saj kapet edhe imazhi i Rozafës, i kumatës më të re, i motrës që pretë vëllain...

Bija shqiptare - Nëna Tereze, që ishte sa tokësore aq edhe qiellore, ishte edhe engjëlli më i madh i shekullit që e lamë pas. Ajo ishte zëri i shekullit XX, që kërkoi ndërgjegjësimin e

njeriut. Shenjtëria e saj e mëposhti mëkatin. Pra, Nëna Tereze ishte simbol i amshuar dhe tokësor i forcës hyjnore të dashurisë së njeriut për njeriun. Ajo paraqiste ngrehinën më madhështore të tempullit shpirtëror të dashurisë.

Po, por Nëna Tereze ishte edhe një vlerë ekumenike, kurse për ne shqiptarët ajo ishte edhe diçka më shumë: ishte një vlerë etnike, frymë e trojeve tona historike, ishte e mbirë nga zemra e dheut tonë shekullor, ishte bijë e motër e fisit tonë më të stërlashtë, përkatësisht për ne shqiptarët ajo ishte pjesë e krenarisë kombëtare dhe e identitetit tonë.

Fama e Nënë Terezës i kaloi të gjithë kufijtë. Ajo ishte shqiptarja më e famshme në botë e të gjitha kohërave. Ishte kryeinstitucion i mëshirës njerëzore. Mirëpo, ishte edhe laurate e një deti dekoratash, nderimesh e shpërblimesh. Bile, ajo ishte edhe lauratja e parë shqiptare e çmimit Nobel për paqe. Nëna Tereze ishte shenjtëreshë e gjallë, ishte shëmbëlltyrë e një nëne shqiptare, që u ngrit në një figurë të një nëne dhe të një të shenjtës së gjithë njerëzimit. Prej nobelistëve shqiptarë, sikurse edhe nga të huajt, nuk na vie asnjë e keqe. Në fakt, me ta duhet të krenohet mbarë populli shqiptar, mu ashtu siç krenohet sot me Nënë Tereze dhe me Ferid Murati, nobelistët e vetëm shqiptarë deri më tash.

Vargut të shenjtërve u shtohet edhe Nëna Tereze

Mjerisht historia jonë kombëtare pak apo aspak nuk i njej shenjtërit iliro-arbëro-shqiptarë, përkatësisht deri të humanistja më e madhe në botë, paqetorja botërore, nobelistja e parë shqiptare - Nëna Tereze, që ishte bijë, motër e nënë e shqiptarëve dhe nënë e mbarë njerëzimit të botës. Nëna Tereze ishte shenjtëreshë e gjallë e shekullit XX. Ajo ishte kala e fortë shqiptare, shtatshkurtër, por që globin e ushqeu me dashuri.

Vargut të shenjtërve iliro-arbëro-shqiptare, dhe jo vetëm atyre, para dy vjetësh, iu shtua edhe Gonxhe Bojaxhiu, alias Nëna Tereze, bijë e motër shqiptare e nënë e mbarë njerëzimit pa dallim race, feje apo kombi.

Me shpalljen e Nënës Tereze të lume (19 tetor 2003), ajo u ngrit në lëterin e kishes. Kjo e bënë atë që t'i shpallet dita e festës së saj, t'i kushtohen meshë si dhe tash e tutje t'i lutemi asaj, sidomos që nga viti i ardhshëm, kur kremtojmë 100-vjetorin e lindjes së Nënë Terezës, e cila edhe vitin tjetër edhe do të shenjtërohet.

Padyshim se bija, motra dhe nëna jonë dhe e mbarë njerëzimit Gonxhe Bojaxhiu, përkatësisht Nëna Tereze, tashmë e ka marrë rrugën e ngritjes së saj në pedestalin e besimit të krishterë. Tashmë ajo është edhe e shenjte, ndaj edhe mu për këtë edhe u pagëzua Katedralja në Prishtinë, e cila çdo ditë e më shumë po lëshon shtat.

Pikërisht më 5 shtator 1997 Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Tereze kishte kaluar në amshim. Me atë rast i tërë rruzulli i botës kishte përjetuar vdekjen fizike të njeriut që jetën ia kushtoi dashurisë njerëzore. Mu për këtë edhe lirisht mund të pohohet se ndër personat më të ndritur, që pati njerëzimi gjatë dymilëniumit të kaluar, e veçmas gjatë shekullit XX, e i cili i përmbylli 2000 vjet të lindjes së Jezu Krishtit dhe të krishterimit ndër shqiptarë, ishte figura e Gonxhe Bojaxhiut - Nënës Tereze shqiptare.

Nëna Tereze, duke u lindur në shekullin XX, i dha këtij forcën, admirimin dhe suksesin, për t'u parë se ku e ka origjinën, por edhe folen vepra e mirë, humaniteti, sakrifica, nderi, morali, besimi e dashuria.

Nëna Tereze u lind për t'u rilindur

Dhe, pikërisht më 10 dhjetor të këtij viti (2009), bëhen plotë 30 vjet që kur Nëna Tereze u laureua me Çmimit Nobel për Paqe (10 dhjetor 1979 në Oslo të Norvegjisë). Që nga ajo kohë edhe bota u përkulë para saj si ikonë dhe afreskë e kohëve moderne. Bile, në përvjetorin e 30 të laureimit të saj me Nobel, sivjet u laureua me këtë Çmim (Nobel) për paqe edhe Presidenti i SHBA-ve, Barak Obama. Shenjtëria e saj për së gjalli mposhti mëkatin. Ajo shëlboi dhe na liroi ne (shqiptarëve) dhe mbarë botën nga robëria shpirtërore dhe mëkati. Ajo u bë

dëshmitare e vërtetë në kohë dhe në hapësirë për shëlbimin e njeriut, sepse me punën dhe flijimin e pashoq u bë simbol dhe krijuese e filozofisë së bamirësisë, humanitetit, paqes dhe dashurisë njerëzore.

Humanizmi gjenetik i Nënë Terezës bazohet në një ridimension të një ungjillizimi gjithashtu të ri në botë. Ajo nuk u lind rastësisht, jo vetëm si shqiptare, por edhe si përfaqësuese e njerëzimit. Ndaj, edhe nuk mund të ketë emancipim të shqiptarëve pa Nënë Terezën. Bile, ne shqiptarët gjithmonë do të kemi nevojë për Nënë Terezën, për porositë e një jete që e ushqe me dashuri dhe shpresë. Ajo u lind për t'u rilindur në amëshim. Mu për këtë edhe Bill Clinton, ish president i SHBA-ve, për Nënë Terezën kur ishte çështja e Kosovës ndër të tjera thotë se: "Nëna Tereze ishte e para, që më bëri ta dua kombin shqiptar. Dhe tani ndjehem krenar që plotësova një detyrë morale ndaj Saj dhe ndaj vlerave universale të lirisë".

Ferid Murati - nobelisti i dytë shqiptar

Ferid Murati ishte i biri i Murat Xhabir Ejupit, nga Llakovica e Gostivarit të Maqedonisë dhe i nënës Henrietta Josephine Bowman nga Altona e Ilionisit të SHBA-ve. Prof. dr. Ferid Murati u lind më 14 shtator të vitit 1936 në Witing të Indianës të SHBA-ve, që do të thotë se Ferid Murati rrjedhte nga babai shqiptar dhe nëna amerikane. Nga kjo del se ai ka prejardhje shqiptare, por që edhe e ndien veten shqiptar.

Ferid Murati së pari diplomoi në shkencat shoqërore në Universitetin "De Pauw" në Greencastle (Indiana), pastaj "MD" diplomon në Universitetin "Western Reserve", degën e mjekësisë në Cleveland të Ohio-s, si dhe "PhD" kryen Departamentin e Farnakologjisë në Universitetin e lartë përmendur. Ai pasi i kishte fituar të gjithë titujt shkencor, kishte punuar në shumë vende mjekësore të një rëndësie të veçantë.

Dr. Ferid Murati, që njëherësh ishte edhe president i Departamentit për Biologji Intergrative dhe Farmakologji në Universitetin e Teksasit, e fitoi Çmimin Nobel bashkë me Robert Furchgott dhe Louis Ignarro. Që të tre kanë punuar në mënyrë të pavarur në hulumtimet themelore të oksidit nitrik. Gjatë hulumtimeve Ferid Murati vërejti se oksidi nitrik ka mundësi t'i dilatojë enët e gjakut dhe të relaksojë muskulaturën e lëmuar që çon deri te aplikimi i pilulave kundër impotencës (Viagra). Po ashtu, ai ka zbuluar se oksidi nitrik është relevant në luftën kundër kancerit, sëmundjes së Al-zeimerit dhe sëmundjeve të zëmrës. Murati po ashtu ka zbuluar në vitin 1997 pilulat me nitroglicerinë, që i përdorin pacientët që vuajnë nga zemra (NO). Gazi pa ngjyrë dhe pa erë i sinjalizon enët e gjakut që të relaksohen, gjë që e ulë shtypjen e gjakut dhe e qetëson dhembjen nga angina pektoris.

Kadare u propozua disa herë për Nobel

Dhe, shqiptari i katërt që u propozua për çmimin Nobel - Ismail Kadare, dy prej të cilëve janë laurua me atë çmim (Nëna Tereze dhe Ferid Murati) edhe sot e kësaj dite nuk e pat fatin deri më tash ta merr Nobel-in. Ismail Kadare padyshim se e meriton këtë çmim, por që t'i bësh kur ka pasur raste kur e kanë kontestuar vetë shqiptarët.

Prej nobelistëve shqiptarë, sikurse edhe nga të huajt, nuk na vie asnjë e keqe. Në fakt, me ta duhet të krenohet mbarë populli shqiptar, mu ashtu siç krenohet sot me Nënë Tereze dhe me Ferid Murati, nobelistët e vetëm shqiptarë deri më tash.

Legjenda: **Nëna Tereze**